



Në kuadër të Memorandumit të Mirekuptimit të nënshkruar mes Komunës së Gjakovës dhe të programit ReLOaD3 (Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor3), që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), shpallim këtë:

FTESË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE DHE QYTETARË

Në kuadër të Thirrjes së Parë Publike për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) për Dorëzimin e Projekt Propozimeve në Programin ReLOaD3 që do të shpallet së shpejti, ftohen të gjitha OSHC-të e interesuara dhe qytetarët të marrin pjesë në **Diskutimin Publik** mbi prioritetet e propozuara nga ana e komunës, të cilat korrespondojnë me planet zhvillimore të komunës dhe synojnë të jenë në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Të gjitha OSHC-të dhe qytetarët e interesuar do të kenë mundësi të diskutojnë dhe shprehin mendimet e tyre mbi këto prioritate të propozuara, në kuadër të çilave do të hartohen kriteret dhe aplikacioni për thirrjen e parë publike në kuadër të Programit ReLOaD3.

Diskutimi Publik do të mbahet më: **20 janar 2026**, në Sallën Solemne në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi", me fillim nga ora 10:00 – 11:00.

Ju mirëpresim,